



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1887/14 prot.

Tiranë, më 08.05/2020

URDHËR

Nr. 305, datë 08.05.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR 263 DATË 17.04.2020 "PËR PËRCAKTIMIN E ORAREVE TË LËVIZJES PËR KËMBËSORËT PENSIONISTË, TË SËMURËVE KRONIKË NË TRAJTIM MJEKËSOR DHE TË RREGULLAVE PËR LËVIZJEN E MJETEVE PRIVATE" TË NDRYSHUAR.

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7 të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në Urdhrin nr. 263 datë 17.04.2020 "Për përcaktimin e orareve të lëvizjes për këmbësorët, pensionistë, të sëmurëve kronikë në trajtim mjekësor dhe të rregullave për lëvizjen e mjeteve private" të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet si vijon:

"1. Lejohet lëvizja e këmbësorëve pensionistë, ditën e shtunë dhe ditën e diel, datë 9 dhe 10 maj 2020 deri në orën 10:00, të shoqëruar me jo më shumë se një person në krah."

2. Pika 1/1 riformulohet si vijon:

"1/1. Lejohet lëvizja e prindërve me fëmijëve deri në moshën 14 vjeç, ditën e shtunë dhe ditën e diel, datë 9 dhe 10 maj 2020, nga ora 11:00 deri në orën 17:30, të pashoqëruar me persona të tjerë në krah"

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

